

Tiranë me, 26.07.2019

FTESË PËR OFERTË

Lyerje e brendshme e 8 vilave pranë SOS Fshatrat e Femijeve Shqiperi

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë në familjet e tyre biologjike. SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët dhe familjet në nevojë përmes projekteve komunitare, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve. SOS Fshatrat e Fëmijëve është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare, SOS Kinderdorf International, krijuar nga Herman Gmeiner në vitin 1949. Ajo është prezente në 132 vende në botë në shërbim të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve.

Misioni ynë: Ne krijojmë familje për fëmijët në nevojë, ne i ndihmojmë ata që të ndërtojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

Qëllimi i kësaj kërkesë për ofertë është Lyerje te brendshme te 8 vilave (shtëpive familje) dhe nje godine ne kuader te nje projekti qe SOS Fshatrat e Femijeve Shqiperi zhvillon.

Për ofrimin e këtij shërbimi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri fton të gjitha kompanitë që të paraqesin interesin e tyre para datës 15.08.2019, duke paraqitur ofertat financiare dhe dokumentat plotësuese të mbyllura në zarf.

MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj dorazi me vulë dhe emërtimin “Ofertë për prokurim për Lyerje te brendshme te vilave” dhe kompania që e dorëzon, pranë zyrave të shoqatës sonë deri më datë 15.08.2019 ora 16:30 me adresë:

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri
Rruga Herman Gmeiner, Sauk
Tiranë

Zarfi duhet të protokollohet pranë sekretarisë të Zyrave dhe Kompania duhet të sigurohet që kjo ofertë është protokolluar. Për të shmangur çdo paqartësi, kërkojmë që përfaqesuesi i kompanisë të mos largohet pa marrë numrin e protokollit të ofertës.

Në rast se oferta juaj dorëzohet e hapur, me e-mail, fax ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ajo e kërkuar më lart, oferta nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave në SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në adresën e mësipërme është datë 15.08.2019 ora 16:30

Oferta duhet të jetë e vlefshme për minimumi 30 ditë.

Dokumentat duhet të përmbajnë:

1. Të gjitha specifikimet teknike (cilësinë dhe llojin e bojës qe do te përdoret)
2. Grafikon e punimeve

Këto dokumenta duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura.

Gjithashtu Kopje te Ekstraktit Historik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit jo më parë se një muaj.

Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: Rineta.Sheme@soskd.org.al
Përgjigjet e pyetjeve do të ndahen me të gjitha kompanitë që marrin pjesë në tender në version elektronik.

Propozimi juaj, nëse pranohet, do të ndihmojë për hartimin e kontratës ndërmjet kompanise tuaj dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Specifikimet teknike të nevojshme:

Siperfaqet qe do lyhen jane sipas specifikimeve ne tabelen me poshte.

	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Cmimi bojes/m2	Kosto e punes/m2	Vlera
1	Siperfaqe e brendshme anesore	M2	4032			
2	Siperfaqe tavane	M2	1647			
3	Fasade e jashtme	M2	967			
4	Bojë hidroplastike cilesise se pare	Litra				
5	Bojë hidroplastike cilesise se dyte	Litra				
	SHUMA					
	TVSH 20%					
	SHUMA TOTALE:					

Informacionet e nevojshme që duhet të përfshihen në ofertë:

- bojë hidroplastike cilesise se pare ose te dyte për ambiente të brendshme (holle, kuzhina, dhoma gjumi, korridore, banja, zyra, salla etj). Të specifikohet lloji i bojës dhe cmimi për të dy cilesitë.
- ngjyra të ndryshme të përshtatshme për mjediset përkatëse.
- Kostoja e bojës te specifikohet e ndarë nga kostoja e punës.

Informacion teknik:

Data për fillimin e punimeve	5 ditë nga njoftimi për ofertën fituese
Dërgesa	Fshati SOS, rruga Hermann Gmeiner, Sauk, Tirane
Tarifat e transportimit	E përfshirë në ofertë
Monedha e preferuar e tenderimit	Monedha lokale: Lek
Kushtet e pagesës	Me bankë
Tipi i kontratës	Kontrate sherbimi
Personi i kontaktit për kërkesat (Vetëm kërkesa të shkruara)	Rineta.Sheme@soskd.org.al

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit dhe kërkesave teknike, si dhe cilësinë e specifikimeve teknike të ofruara në varësi të fondit limit.



SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.